



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201700572/2**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:**     *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.*

**Drejtuar:**    **Z. Armando SUBASHI**  
                  **Kryetar i Bashkisë**

**FIER**

**Zj, Etleva BISHA**  
**Drejtoreshë e Shërbimit Social Shtetëror**

**TIRANË**

**Për dijeni:**   **Znj. Daniela HASIMAJ**  
                  **Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve**

**FIER**

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të njeriut, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 05.05.2017, kanë inspektuar Shtëpinë e të Moshuarve, Fier.

Në takimin e bërë me drejtuesen e kësaj qendre, u informuam se aty trajtoheshin persona të moshuar duke filluar që nga mosha 60 vjeç për gra dhe 65 për meshkuj. Kapaciteti i përfituesve në këtë qendër është 60 persona, por aktualisht strehoheshin 54 të moshuar, 13-femra dhe 41-meshkuj. Përfitues të pensionit të pleqërisë ishin 52 të moshuar.

Nga inspektimi i kryer rezultoi si më poshtë:  
Personeli i kësaj qendre përbëhej nga 20 punonjës, të cilët ishin punësuar me kontratë. Përshkrimi i punës është përcaktuar në Rregulloren e qendrës.  
Me problemet psiko-sociale merrej vetëm punonjësja sociale dhe kujdestarët.

Vlerësimi i punës për personelin bëhet çdo vit dhe vendoset ne dosjen personale.

Bëhej plani individual për çdo të moshuar dhe vendoset në dosjen sociale të tyre.

Shërbimi mjekësor realizohej nga një mjek me kohë të pjesshme (4 orë në ditë).

Lidhur me vizitat e nevojshme mjekësore, kur të sëmurët janë në gjëndje të rëndë, shoqërohen nga stafi i qendrës.

Vizita dentare janë bërë, por vetëm për probleme të lehta.

Kuota ushqimore prej 300 lekë në muaj ishte e mjaftueshme. Kampionët e ushqimeve ruheshin në frigorifer. Për ushqimin dhe përcaktimin e menysë si dhe të vakteve të ngrënies merrej mendimi i të moshuarve. Caktohet një ditë në javë që merret mendimi i tyre dhe firmoset menyja nga vetë të moshuarit.

Në ambiente të veçanta ishin vendosur standartet që duhet të respektonin punonjësit e qendrës. Ishte e vendosur kutia e ankesave dhe çelësi mbahej nga punonjësja e Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier.

Mjetet për shmangjen e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të caktuara. Gjithashtu kishte edhe shkallë emergjence. Stafi është i trajnuar për përdorimin e këtyre mjeteve.

Furnizimi me artikuj hotelerike është realizuar me fondet e Shërbimit Social Shtetëror.

Gjatë vitit 2016 ka patur një shtesë fondi nga ana e Bashkisë Fier, në pajisje kuzhine. Aktualisht po kryhej ristruksioni i godinës, por ende nuk është çelur fondi për "investime".

Në katin e parë të ndërtesës kishte 8 dhoma. Në këtë kat qëndrojnë të moshuar meshkuj dhe ata që janë të rënduar nga ana shëndetësore. Kishte një tualet të përbashkët, me 2 wc dhe 3 dushe. Aktualisht ky kat po lyhej.

Në katin e dytë ishin dhomat ku strehoheshin të moshuar burra dhe gra. Kishte dy tualete për burrat, me 4 wc dhe 2 dyshe si edhe 1 tualet për gratë, me 3 wc dhe 1 dush.

Në çdo dhomë qëndrojnë nga dy të moshuar. Tualetet nuk janë nëpër dhoma. Të moshuarit çohen natën, shkojnë në tualet shumë shpesh dhe kjo krijon problem për ta.

Janë bërë rikonstruksione të tualeteve në katin e parë dhe të dytë të burrave. Rikonstruksioni i kuzhinës është bërë me fondet e Shërbimit Social Shtetëror, ndërsa pajisjet me fondet e Bashkisë Fier. Është bërë rikonstruksioni i tarracës.

Aktualisht po lyhej e gjithë godina. Kati i dytë nuk kishte më lagështirë, ndërsa në katin e parë ka vetëm në korridore. Gjatë vitit 2017 do bëhej rikonstruksioni i tualeteve të grave dhe pjesërisht menca (shtrimi me pllaka).

Dhoma ku zhvilloheshin ritet fetare në çastet e fundit të jetës kishte lagështirë, por ishte në rikonstruktivim.

Ngrohja realizohet me kaldajë dhe nuk kishte probleme.

Me qëllim dhënien e menjëhershme në rast të rënies së zjarrit nëpër dhoma si dhe të problematikave të tjera, është kërkuar pranë Shërbimit Social Shtetëror shtesë fondi për vendosjen e kamerave në korridore dhe sistemit të alarmit në çdo dhomë.

Organizohen aktivitete dhe ekskursione të ndryshme, ditëlindje, etj. Të moshuarit dërgohen në plazh gjatë sezonit të verës, në Seman dhe Zvërnec.

Ata vizitohen nga të afërm, sidomos nga emigrantët, të cilët vijnë në Shqipëri gjatë periudhës së pushimeve dimërore apo verore.

Monitorimi i standarteve bëhej një ose dy herë në vit, sipas problematikave, nga Bashkia Fier, Shërbimi Social Shtetëror, nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimit Social, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier.

Sipas një marrëveshje, nxënës të shkollës së mesme profesionale “Rakip Kryeziu”, Fier, vijnë të shkonin katër herë në javë në mënyrë vullnetare pranë të moshuarve për t'i matur tensionin, për të pastruar oborrin dhe ambientet e kësaj qendre, etj.

Gjatë këtij inspektimi u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Në organikën e punonjësve të qendrës janë 5 kujdestarë, të cilët punonin me tre turne. Kjo e papërbalueshme për shërbimet ditore, bazuar në standartet e shërbimeve sociale.
- Një problem shqetësues i përhershëm është edhe ajo e mjekut part-time, pasi siç e kemi theksuar në të gjitha rekomandimet e bëra nga inspektimet në Shtëpitë e të Moshuarve, të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë tërë kohës i pranishëm në qendër.
- Gjithashtu si një problem imediat është edhe mospasja e një mjeti transporti në dispozicion, duke krijuar vonesa në transportin e tyre në spital.
- Në këtë qendër ka të moshuar me probleme mendore, që kanë nevojë për asistencën e një psikiatri si dhe për të gjithë të moshuarit e tjerë për asistencën e një psikologu.
- Kishte një roje vetëm pasdite dhe jo 24 orë.
- Personeli nuk ka kopje të kontratave të punës, pasi mbahen në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Fier, e cila kryen shpallje e vendeve vakante dhe rekrutimet. Ato nuk kanë nënshkruar kontratën e punës, por disponohet vetëm vendimi për fillimin e punës nga Kryetari i Bashkisë Fier. Është lënë detyrë nga Shërbimi Social Shtetëror që më datë 02.12.2016 dhe i është kërkuar Bashkisë Fier që të lidhen kontratat e punës të personelit më Bashkinë si dhe të shtohen 2 kujdestarë dhe një roje objekti. Kjo kërkesë është bërë edhe nga Drejtoresha e Shtëpisë së të Moshuarve.

Sa më lart, për të plotësuar standartet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

## REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për:

1. Shtimin në organikë me 2 kujdestarë, mjek me kohë të plotë, psikiatër, psikologë dhe roje objekti.
2. Shtim fondi për vendosjen e kamerave dhe sistemit të alarmit në çdo dhomë.
3. Mundësinë e vënies në dispozicion të një mjeti.
4. Të lidhet kontrata e punës ndërmjet personelit të Shtëpisë së të Moshuarve Fier dhe Bashkisë Fier, e cila të nënshkruhet dhe t'u jepet atyre një kopje të kontratës së nënshkruar.
4. Të ketë vijimësi të rikonstruksionit të kësaj godide, e cila është e vjetër dhe ka nevojë për rregullime herëpahershme.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se,

*"Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",*

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**